

Mead Osmani, “Sanxhaku i Nishit gjatë periudhës osmane (Shek. XIX)” (fq.369), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Alban Dobruna*

Librat që kanë objekt studimi Sanxhakun e Nishit, janë të rrallë në gjuhën shqipe, për shkak të rrethanave specifike në të cilat u zhvillua historiografia jonë, në kushtet e pushtimit sistematik dhe mungesës së burimeve relevante. Për këtë arsye çdo vepër me një përmbajtje të tillë është me interes të veçantë për studiuesit dhe të apasionuarit pas historisë. Prandaj ndihemi me fat, që kemi në dorë një libër të mirë nga autorit Mead Osmani. “Sanxhaku i Nishit gjatë periudhës osmane (Shek. XIX)”, i botuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë më 2022, i cili paraqet pa dyshim një kontribut të madh jo vetëm për historiografinë shqiptare, por edhe për historiografinë e Ballkanit në përgjithësi. Prof. Asoc. Dr. Mead Osmani, i diplomuar në Fakultetin e Filologjisë, në degën e Orientalistikës të Universitetit të Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare dhe doktoratën në Universitetin Uludağ (Bursa Uludağ Üniversitesi), në qytetin e Bursës në Turqi, është autor i artikujve të shumtë me karakter studimor dhe publicistik në revista dhe gazeta ditore, pjesëmarrës dhe kontribuues në veprimtari të shumta dhe të larmishme arsimore dhe social-kulturore, në tubime, tryeza dhe konferenca shkencore.

Ky studim i Mead Osmani i cili është punuar si tezë doktrate, është fryt i një pune studimore të kujdesshme shumëvjeçare, në dhjetëra vepra e artikuj të cituara në pjesët e saj dhe gjithashtu i hulumtimeve nëpër arkiva, ku ruhen dorëshkrime të vyera që lidhen me temën.

* Prof. Asoc. Dr. Alban Dobruna, Institutin e Historisë “Ali Hadri” Prishtinë. ORCID nr. 0000-0002-8598-2976, e-mail: dobrunaalban9@gmail.com

Ky studim është një sintezë të një përgjithësimi të studimeve dhe njohjeve të deritanishme të Nishit, duke sjell edhe prurje të reja arkivore dhe historiografike, kryesisht ato osmane. Në këtë kontekst, ky studim bazuar në këto burime, analizon aspektet e përgjithshme, strukturën administrative, demografinë, arsimin, institucionet shoqërore dhe zhvillimet politike dhe sociale që ndikuan në Sanxhakun e Nishit gjatë shek. XIX.

Kjo monografi, përveç hyrjes dhe përfundimit, përbëhet nga tre kapituj kryesorë. Në pjesën e hyrjes janë përshkruar qëllimet dhe objektivat e punimit, metodologjia, rëndësia e temës, burimet, bibliografia dhe referencat. Në kapitullin e parë është trajtuar pozita gjeografike e Nishit, etimologjia e emrit “Nish” dhe historiku i tij para dhe gjatë periudhës osmane dhe është përpunuar struktura administrative e Sanxhakut të Nishit gjatë periudhës osmane. Veçanërisht janë trajtuar ndryshimet administrative gjatë periudhës së Tanzimatit në detaje përmes tabelave.

Në kapitullin e dytë është shqyrtuar demografia, sistemi edukativo-arsimor, institucionet sociale, struktura arkitekturore dhe kazatë e Nishit. Ndërsa në kapitullin e tretë dhe të fundit janë analizuar faktorët politik që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në sanxhakun e Nishin të shek. XIX gjegjësisht kryengritjet, projektet e ndryshme, luftërat, shpërnguljet, sistemimi i të shpërngulurve. Pra, trajtohen zhvillimet politike, sociale dhe ndërkombëtare që prekën Sanxhakun e Nishit në atë periudhë. Me fjalë të tjera, ky studim synon të paraqesë në të gjitha aspektet gjendjen e sanxhakut të Nishit në shek. XIX, periudhën që ishte më e vështirë dhe më e turbullta për Perandorinë Osmane.

Duke analizuar këtë monografi, konsideroj se si i tillë përbënë një impuls të rëndësishëm në trajtimin e ngjarjeve historike në hapësirën gjeografike shqiptare, duke i bërë një shërbim të jashtëzakonshëm historiografisë shqiptare dhe të gjithë studiuesve të shkencave shoqërore, për trajtimin e temave që kanë të bëjnë me historinë e popullit shqiptarë, pasi aspekti administrativ gjatë shekullit XIX, ka filluar të zë një vend të rëndësishëm në studimet historike.

Veçanërisht sanxhaqet përmbajnë një pjesë shumë të rëndësishme të historisë së qyteteve, ku shtjellohen çështjet më të rëndësishme të

historisë osmane. Sanxhaqet përbëjnë njësitë administrative më të vjetra të strukturës (administrative) shtetërore osmane. Sanxhaqet si njësi administrative janë të njohura në historiografinë tonë, por trajtimi i një sanxhaku veçmas në një periudhë të caktuar si në këtë studim, mendojmë se përbën një model për studimet e ardhshme. Sanxhaku, për të cilin flitet në detaje në këtë libër, është një koncept që përfaqëson përgjithësisht sistemin administrativ të rajoneve krahinore në periudhën osmane.

Nga këndvështrimi im si historian, mund të them se nga libri me titull: "Sanxhaku i Nishit gjatë periudhës osmane (Shek. XIX)", i autorit Mead Osmani, fitohen mjaft informacione historike, pasi realizimi i këtij projekti kaq të madh kërkon një angazhim dhe përdorim të burimeve dhe të literaturës shkencore përkatëse.

Ndaj edhe autori ka bërë krahasime me burime nga autorë të huaj, me një qasje kritike të burimeve serbe, të cilat gjithmonë kishin tendenca destruktive në historiografi, sidomos për strukturën e popullsisë në Sanxhakun e Nishit gjatë shek. XIX. Me rëndësi të madhe është, se autori Osmani, monografinë e ka trajtuar me një stil të qartë e të rrjedhshëm dhe lehtësisht të kuptueshëm nga lexuesi, të përpiluar me kujdes, mbështetur në metodologji shkencore-bashkëkohore të përmbledhura në 367 faqe.

Ka një varg arsyesh të forta që këtë monografi e bëjnë tërheqëse, jo vetëm për studiuesit e historisë dhe gjurmuesit, por edhe për ata që ushqejnë simpati dhe dashuri për studimin e së kaluarës, ndonëse është shkruar kohë pas kohe në artikuj të ndryshëm dhe flitet shumë për Nishin. Duke u mbështetur në burimet me shqyrtime të hollësishme, libri dëshmon se ka nevojë për shkrime të tjera për ta sqaruar më mirë këtë periudhë, pasi Perandoria Osmane zë një vend të rëndësishëm në historinë botërore dhe se ajo kishte një identitet universal. Struktura shoqërore e këtij shteti, i cili shtrihej në tri kontinente, përbëhej nga kultura, gjuhë, religjione dhe kombe të ndryshme. Perandoria Osmane, për aq sa ishte e konsoliduar tregoi shembullin e suksesshëm të menaxhimit të mirë të këtyre kombeve brenda një organizate në Ballkan dhe më gjerë.

Ballkani është një gjeografi ku shumë kombe kanë jetuar së bashku gjatë periudhës osmane. Në këtë kontekst, Sanxhaku i Nishit përbën një shembull interesant të kësaj bashkëjetese. Nishi me rrethinë ka qenë një ndër vendet e preferuara që në kohërat e lashta, kjo për shkak të pozitës së volitshme gjeografike dhe strategjike.

Për këtë u ka rezistuar shumë shteteve gjatë historisë që kanë dashur ta sundojnë këtë rajon. Qyteti i Nishit ishte shkatërruar shumë herë gjatë periudhave të ndryshme të banimit. Mund të thuhet se Nishi, përveç shkatërrimeve të shumta që pësoi edhe gjatë periudhës osmane nga forcat e jashtme, ndonëse në masë më të vogël, por megjithatë ende mbanë gjurmë të kulturës dhe qytetërimit osman.

Arritja shkencore e monografisë së Mead Osmanit është shumë i madh, pasi shënon nivelin më të lartë të autorit në punën e tij kërkimore shkencore në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë. Këto arritje përbëjnë një përpjekje të rëndësishme në trajtimin e ngjarjeve historike në hapësirën gjeografike shqiptare gjatë shekullit XIX, aq shumë të nevojshme, duke plotësuar një zbrazëti në historiografinë shqiptare, që do të jetë burim referimi për studiuesit e mëvonshëm.

In Memoriam

